

## NJOFTIM MBI SEANCËN E SHPALLJES SË VENDIMIT PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT Z. Gëzim Copa



22/02/2024

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore në datën 20.2.2024, për subjektin e rivlerësimit, z. Gëzim Copa, bazuar në ligjin nr. 84/2016, me shumicë votash vendosi:

Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit z. Gëzim Copa, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Në zbatim të pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, të përcjellë për vlerësim etik dhe profesional pranë organit kompetent, të dosjes penale 263 të vitit 2019 për inspektim dhe konstatim të shkeljeve të mundshme disiplinore të subjektit të rivlerësimit.

Vendimi, i arsyetuar me shkrim, nga trupi gjyqësor i kryesuar nga znj. Xhensila Pine, znj. Pamela Qirko -relatore, znj. Alma Faskaj anëtare do t'i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.

Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall sot, në datën 22.2.2024.